

Hyrje

. Shëndësia është një e drejtë e paprekshme për cdo qenie njerëzore. Për të përfituar nga shëndëtësia publike italiane është e nevojshme të nënshkruhesh në Shërbimin Shëndetësor Nacional (SSN)..Cdo person i regjistruar në SSN ka të drejtën e nje mjeku bazë që siguron vizitat ambulatoriale,përshkruan mjekimet dhe bën kërkesat për visita tek specialisti dhe gjithashtu për analiza.. Të gjithë qytetarët e huaj,edhe nëse nuk janë të regjistruar tek Sistemi Shëndetësor Nacional mund të përfitojnë kura shëndetësore bazë pa u senjalizuar tek autoritetet. 112 është numri i vetëm nacional për emergjencat shëndetësore aktiv 24 ore në 24.Shërbimi është falas.

Asistenza shëndetësore për qytetarët e huaj

Asistenza shëndetësore në Itali i përket personave të cilët janë të pajisur me lejen e qëndrimit dhe personave që ka përsipër e që jetojnë me ta.

Pa lejen e qëndrimit në rregull ke të drejtë për shërbimet shëndetësore ambulatoriale dhe spitalore në strukturat publike të urgjencës por nuk mund të përfitosh zgjedhjen e Mjekut të familjes dhe të Pediatrit.

Mund të regjistrohen në SSN qytetarë të huaj që:

- Janë të pajisur me leje qëndrimi dhe punojnë,janë të regjistruar në listat e pritjes ose janë në pritje të sistemimit
- Janë me banim të rregullt
- Kanë bërë kërkesën për rinovim të lejes së qëndrimit(për punësim autonom ose jo,motive familiare,azil,adobtim,kujdestari,nënshtetësi,motive feje,studim)
- Janë familiarët në ngarkim të të huajve në pikat 1,2,3

Nëse je një qytetar jo komuntar që hyn në katëgoritë e mëposhtme:student,persona në nivel,personal fetar,titullar i lejes së qëndrimit për vëndbanim të përzgjedhur,prind mbi 65 vjecë mbushur mbas 5 nëntorit 2008,regjistrimi në SSN është me dëshirë.

Nëse je një qytarë komuntar rezident në Comune të Firenze dhe paguan taksa në Itali,ke të drejtën e regjistrimit në SSN.Nëse nuk përmbush këto kërkesa mund të kërkosh në S.S.N vullnetare.

KUJDES!!!!

Regjistrimi vullnetar i nënshtrohet pagimit të një kontributi vjetor që duhet të bëhet në C/C n.289504 i drejtuar :Regione Toscana.Arsye:kontribut S.S.N me indikacion të vitit aktual

Regjistrimi vullnetar është i vlefshëm për një vit (nga 1 janari deri në 31 dhjetor,pavarsisht nga data e pagimit)dhe mund të përfshijë edhe familjarët që ke përsipër.Duhet të rinovohet cdo vit.

Shuma e pagesës varion në bazë të kategorive të sipërpërmëndura.Për të bërë ndonjë shëmbull:pagesa për një qytetar komuntar apo ekstra komuntar që jeton në Itali për motive studimi është baraz me 149,77 Euro(pa familjar përsipër) ose baraz me 387,34 Euro(me familjar përsipër).

Për një qytetar komuntar apo ekstra komuntar që jeton në Itali i takon pagesa prej 219,49 Euro (pa familjar përsipër) ose 387,49(me familjarë përsipër)

Për kategori të tjera shuma e pagesës varet edhe nga të ardhurat vjetore që ka.

Për informacione

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/servizi-online/servizi-e-attivita/informazione-e-orientamento/784-assistenza-italiani-all-estero-e-stranieri-in-italia/9666-assistenza-sanitaria-ai-cittadini->

[non-appartenenti-all-u-e](#)

Kliko mbi dokumente të nevojshme për dokumente që duhen prezantuar dhe shuma e pagesës.

Kliko mbi Zona Fiorentina për kontakte dhe numra telefoni për informacione dhe qartësime.

Për informacione të mëtejshme : : iscrizionivolontarie@uslcentro.toscana.it

Të qënurit të regjistruar të lejon të:

- Të zgjedhësh mjekun e familjes dhe pediatrin për fëmijët
- Të kesh vizita të përgjithshme në ambulator,specifike dhe vizita në banesë(duke paguar ticket)
- Të mundëson të ndjekësh rrugëzime terapetike në struktura mjekësore të ndryshme
- Të vaksinohesh
- Të bësh analizat e gjakut(duke paguar ticket)
- Të bësh analiza diagnostike(radiografi,ekografi)(duke paguar ticket)
- Të marrësh mjekimet (duke paguar ticket)
- Të bësh rehabilitim (duke paguar ticket)

Ku mund të regjistrohesh në Shërbimin Shëndetësor Nacional në zonën e Firenze

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/medico-di-famiglia-e-pediatra/1432-servizi-medico-di-famiglia-e-pediatria/20568-sportelli-anagrafe-sanitaria>

Kliko mbi “Zona Firenze”

→Documenti da presentare per iscriversi al Sistema Sanitario nazionale:

Dokumenta që duhen prezantuar për regjistrimin në Sistemin Shëndetësor Nacional:

- Dokument identifikimi;
- Leje qëndrimi ose faturen e rinovimit;
- Vërtetim,edhe i autocertifikuar,relative me kryerjen e rezidenccës/banimi dhe /ose vendi ku po jeton në territorin rajonal;
- Kodin fiskal;
- Fotokopje të Dokumentave origjinale të kërkuara më sipër

Karta e Shëndetit

C’farë është karta e shëndetit?

Mbas regjistrimit në SSN do pajisesh me Kartën e Shëndetit elektronike që të jep të drejtën e përfitimit të shërbimeve që ofron Sistemi Shëndetësor Nacional.Karta është rajonale.

Shërbimet dhe mënyrat e përfitimit të shërbimeve shëndetësore mund të jenë të ndryshme nga një rajon në tjetrin.Karta e shëndetit jepet falas dhe është e vlefshme në kohë aq sa leja e qëndrimit.

Kur shërben karta e shëndetit?

Karta e shëndetit shërben kur duhet të shkosh tek mjeku ose tek pediatri,të marrësh mjekimet në farmaci,të prenontosh një analizë laboratoriale,të bësh një vizitë tek specialisti në spital,gjithashtu cdo herë që duhet certifikar kodi fiskal.

→Të huaj që nuk janë të regjistruar në Shërbimin shëndetësor Nacional

Edhe nëse nuk je në rregull me lejen e qëndrimit ke të drejtë për shërbime shëndetësore ambulatoriale dhe spitalore në strukturat publike të urgjencës,por nuk mund të përfitosh shërbimin e Mjekut të familjes apo të pediatri për fëmijë.

KUJDES! Në brëndësi të shërbimeve shëndetësore,nuk do të sinjalizohesh tek forcat e rendit vetëm për faktin që nuk je në rregull me lejen e qëndrimit.

STP,I huaj përkohësisht i pranishëm.Është një kod që i jepet vetëm të huajve që gjenden përkohësisht në territor për të paktën 3 muaj në gjëndje të varfër dhe jo në rregull normat relative të hyrjes dhe qëndrimit. ENI, Europeo Non Iscritto. ENI,Europian i Pa Regjistruar.Është një kartë që i lëshohet qytetarit të huaj komunitar ose baraz,jo rezident në territorin rajonal,që nuk përmbush kushtet për regjistrimin e detyrueshëm në Shërbimin Shëndetësor Rajonal(SSR) dhe nuk shërbehet nga Shteti mëmë dhe që nuk mund të paguaj shërbimet shëndetësore prej varfërisë.

STP dhe ENI kanë një vlefshmëri prej 6 muajsh,të rinovueshme për 6 muaj të tjerë.

KU BËHET KËRKESA PËR KARTAT STP DHE ENI NË FIRENZE:

Adresa në link më poshtë:

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/altri-servizi/784-assistenza-italiani-all-estero-e-stranieri-in-italia/10114-assistenza-in-italia-a-cittadini-extracomunitari-stranieri-temporaneamente-presenti-stp>

Kliko mbi "Zona Firenze"

Dokumenta që duhen paraqitur për të kërkuar karta STP dhe ENI:

- Dokument identifikimi ose autodeklarim me emër,mbiemër,gjini,datëlindje dhe kombësi.
- Deklaratë ku vërtetohet që je në vështirësi ekonomike
- Deklarim ku tregohet pa mundësia për tu regjistruar në Shërbimin Shëndetësor Rajonal (SSR) dhe mungësën e një sigurimi shëndetësor

Adresa e AMBULATOREVE të rezervuar për qytetarë me STP ose ENI në Firenze në link mëposhtë:

<https://www.uslcentro.toscana.it/index.php/servizi-e-attivita/784-servizi-vari/assistenza-italiani-all-estero-e-stranieri-in-italia/10114-assistenza-in-italia-a-cittadini-extracomunitari-stranieri-temporaneamente-presenti-stp>

Kliko në "Aktivitete ambulatoriale" Zona Firenze

	Dita	orari
Morgagni	E Hënë	14 - 17
	E Enjte	14 - 16
Santa Rosa	E martë	10 - 12
	E mërkurë	14 - 16

	E Premte	11:30 - 13:30
D'Annunzio	E Mërkurë	14 – 18

Vëre: Edhe në mungesë të regjistrimit në SSN, është e mundur të përfitosh shërbimin e vaksinimit sipas kalendarit të vaksinave të rajonit.